



Bundesamt
für Migration
und Flüchtlinge

Lini që të këshilloheni

Oferta të këshillimit për imigrante të reja
dhe të rritur dhe imigrantë të rinj dhe të rritur

ALBANISCH



Integration



JUGEND
MIGRATIONS
DIENSTE



MBE

Migrationsberatung
für erwachsene Zuwanderer



Shfrytëzoni ofertën individuale falas të këshillimit për imigrante dhe imigrantë:

Zyrën e këshillimit për migrantët e rritur (MBE) dhe shërbimet e migracionit për të rinjtë (JMD)

Këshillimi individual ndihmon

Në fillim disa gjëra në Gjermani do të jenë të huaja dhe të pazakonta për ju. Edhe kur keni kohë që jetoni në Gjermani, ka ndoshta pyetje për të cilat ju kërkoni një përgjigje.

Lidhur me këtë ju ndihmon një këshillim dhe shoqërim individual që është i gatshëm për ju që në fillim. Ai ofron mbështetje konkrete për gati të gjitha situatat e jetës së përditshme. Kështu ju mësoni që t'i merrni çështjet në duart tuaja dhe të merrni vendime në mënyrë të pavarur.



Oferta të këshillimit për imigrante të reja dhe të rritur dhe imigrantë të rinj dhe të rritur

Zyra e këshillimit për migrantët e rritur këshillon dhe shoqëron imigrante dhe imigrantë të rritur deri në moshën 27 vjeç/e.

Shërbimet e migracionit për të rinjtë këshillojnë dhe shoqërojnë njerëz të rinj me sfond migracioni nga mosha 12 deri 27 vjeç/e.

Parimisht ju mund t'i drejtoheni si zyrës së këshillimit për imigrante dhe imigrantë të rritur, ashtu edhe shërbimeve të migracionit për të rinjtë. Pas bisedës suaj të parë procedura e mëtejshme akordohet midis institucioneve këshillimore. Lidhur me këtë merret parasysh situata juaj personale dhe situata e familjes suaj.

Shanse më të mira nëpërmjet këshillimit individual

Punonjëset dhe punonjësit e institucioneve këshillimore kuptojnë, në shumicën e rasteve, edhe gjuhën e vendit të origjinës suaj. Ata njohin edhe mënyrat e të menduarit dhe të vepruarit shoqëror, kulturor dhe fetar, me të cilat ju jeni të ambientuar. Së bashku me ju ata zhvillojnë një plan që ju jep orientim gjatë hapave të parë në Gjermani. Në qendër të këshillimit qëndrojnë aftësitë dhe njohuritë tuaja personale. Ju mësoni se cilat oferta për mbështetje ekzistojnë, të cilat ua lehtësojnë jetën në Gjermani.

Gjatë këshillimit ju mund të flisni për të gjitha temat e jetës së përditshme, për shembull:

- ✎ për pyetje juridike lidhur me qëndrimin
- ✎ për mësimin e gjuhës gjermane (për shembull përmes pjesëmarrjes në kursin e integritit)
- ✎ shkollimin, formimin profesional (për shembull karriera shkollore, rrugë të formimit profesional, njohjen e diplomave profesionale)
- ✎ aktivitetin profesional (për shembull trajnimin për aplikimin, kërkimin e vendit të punës)
- ✎ situatën ekonomike (për shembull të ardhurat, kredi, borxhe)
- ✎ banimin (për shembull kërkimin e banesës, financimin e banesës)
- ✎ shëndetin (për shembull për sigurimin shëndetësor, përkujdesjen mjekësore)
- ✎ për situatën personale shëndetësore (për shembull për probleme shëndetësore)
- ✎ për martesën, familjen dhe edukimin (për shembull për shtatzëninë)
- ✎ për mobilitetin dhe qarkullimin (për shembull për patentën, mjete të transportit publik)
- ✎ për çlodhjen, sportin dhe kohën e lirë (për shembull për oferta të hapura, anëtarësinë në klube)
- ✎ për aktivitete të përditshme (për shembull për bërjen e pazarit, kontaktin me autoritetet)

Oferta të veçanta të shërbimeve të migracionit për njerëz të rinj me sfond migracioni

Për njerëz të rinj koha e parë në një vend të huaj është tërheqëse, por edhe e lodhshme. Në shkollë, kualifikim dhe profesion si dhe në ndërtim të kontakteve të reja sociale ju duhet të përballoni kërkesa të veçanta. Shërbimet e migracionit për të rinjtë ju ofrojnë këshillim individual, shoqërim intensiv dhe oferta për grupe, të cilat janë orientuar për situatat e veçanta të problemeve dhe pyetjeve tuaja.

Atje ju gjeni ndër të tjera oferta për temat si vijojnë:

- Sistemi i shkollimit dhe i formimit profesional
- Planifikim individual i kualifikimit dhe profesionit (në bashkëpunim me agjencitë lokale për punë)
- Pjesëmarrja në të gjitha fushat e jetës sociale, kulturore dhe politike
- Kontakt me mediat e reja, veçanërisht me programe për mësimin e gjermanishtes



Këshillimi online

Krahas këshillimit personal ju në të dy programet keni mundësi që të lini të këshilloheni online. Këshillimi online „mbeon“ dhe portali i këshillimit “jmd4you” ju ndihmojnë që të sqarohen pyetjet tuaja edhe brenda një afati të shkurtër!

Nëpërmjet “mbeon” ju merrni shoqërim dhe mbështetje individuale në formaton 'chat' dhe ju mund t'i shtroni pyetjet tuaja 24 orë në ditë. Këshillimi bëhet nëpërmjet aplikacionit “mbeon” dhe është i mundshëm në shumë gjuhë. Tek “mbeon” ju gjeni këshilltarë, të cilët flasin gjuhën tuaj dhe janë të gatshëm për ju.

- www.mbeon.de

Për migrante të reja dhe migrantë të rinj deri në moshën 27 vjeç / e ekziston mundësia e këshillimit online. Pyetje mund të shtrohen publikisht nëpërmjet një funksioni 'chat' ose në mënyrën individuale. Përgjigja bëhet nga punonjës me eksperiencë të Shërbimit për migracionin e të rinjve ("JMD").

- ↳ gjermanisht www.jmd4you.de, si dhe në
- ↳ anglisht www.your-way-in-germany.org
- ↳ rusisht www.putjwgermaniju.org
- ↳ turqisht www.almanyayolu.org
- ↳ arabisht www.bousaletuk-fi-almanya.org
- ↳ shqip www.udherrefyesi-gjermani.org

Pyesni gjithmonë edhe anëtarë të familjes, persona të me të cilët keni miqësi, kolege pune dhe kolegë punë, bashkënxënëse dhe bashkënxënës, bashkësinë e shtëpisë suaj ose anëtarë të klubit tuaj sportiv për oferta konkrete të këshillimit.

Informohuni për oferta të këshillimit falas dhe shfrytëzoni ato!

Ku merrni informacione të mëtejshme për ofertat e këshillimit?

Informacione mbi oferta konkrete të këshillimit ju merrni në këto institucione të regjionit tuaj, veçanërisht tek

- administratat e komunave, qyteteve ose rretheve (Gemeinde-, Stadt- oder Kreisverwaltungen)
- shoqatat ombrellë të përkrahjes së lirë sociale (Mirëqenia e punëtorëve (Arbeiterwohlfahrt), Shoqata e Karitasit Gjerman (Deutscher Caritasverband), Xhakonia e Gjermanisë-Organizata Evangjelike për Xhakoni dhe Zhvillim (Diakonie Deutschland-Evangelisches Werk für Diakonie und Entwicklung), Kryqi i Kuq Gjerman (Deutsches Rotes Kreuz), Shoqata e Barabartë Bamirëse Gjermane (Deutscher Paritätischer Wohlfahrtsverband), Zyra Qendrore e Përkujdesjes Sociale e Çifutëve në Gjermani (Zentralwohlfahrtsstelle der Juden in Deutschland))
- Shoqata e të Dëbuarve (Bund der Vertriebenen)
- Shoqata Ndërkombëtare (Internationaler Bund)
- mbartësit e punës sociale për të rinjtë (Träger der Jugendsozialarbeit)
- mbartësit e kurseve të integritimit (Träger der Integrationskurse)

Informacione në internet merrni nën:



- www.bamf.de/DE/Themen/Integration/ZugewanderteTeilnehmende/BeratungErwachsene/beratung-erwachsene-node.html



- www.mbeon.de dhe



- www.facebook.com/mbeon.chat



- www.jugendmigrationsdienste.de

Dëftuesi i botimit

Botuesi:

Bundesamt für Migration und Flüchtlinge
90461 Nürnberg

Gjendja:

10/2020

Shtypshkronja:

Silber Druck oHG, Lohfelden

Dizajn:

MediaCompany – Agentur für Kommunikatikon GmbH

Vërtetim pamjesh:

istock / sturti, istock / lisegagne, istock / SDI Productions,
BAMF / Bildkraftwerk / Thomas Geiger

Mundësitë e porositjes:

Publikationsstelle des Bundesamtes für Migration und Flüchtlinge
www.bamf.de/publikationen

Ju mund ta shkarkoni këtë publikim edhe si dokument PDF pa pengesa nën:
www.bamf.de/publikationen

Ky publikim do të botohet nga Enti Federal për Migracion dhe Refugjatë në kuadrin e punës së tij publike. Publikimi jepet falas dhe nuk është përcaktuar për t'u shitur.



Na vizitoni ne në

www.facebook.com/bamf.socialmedia

[@BAMF_Dialog](https://twitter.com/BAMF_Dialog)

www.bamf.de

Other Language 

www.bamf.de/publikationen